

V E N D I M
Nr.26, datë 31.1.1994

PËR MBETJET E RREZIKSHME DHE MBETURINAT

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Republikën e Shqipërisë është i ndaluar importimi i mbetjeve të rrezikshme në gjendje bruto ose të përpunuar dhe i mbeturinave me qëllim depozitimi.

2. Në kuptim të këtij vendimi:

a) "Mbetje të rrezikshme" janë lëndët toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përflakshme, kancerogjene dhe radioaktive, të afta për të shkaktuar ndryshimin ose krijimin e një lënde tjetër, duke pasur edhe cilësinë për të shpejtuar djegien e për të prishur gjendjen natyrore të ujit, tokës e ajrit, duke dëmtuar njeriun dhe të gjitha qëniet e gjalla në mjedisin natyror.

b) "Mbeturina" janë mbetjet nga veprimtaritë ekonomike e sociale dhe prodhimet e konsumuara fizikisht që nuk përbëjnë mbetje të rrezikshme.

c) "Prodhuesit" janë personat juridikë ose fizikë, nga veprimtaritë e të cilëve prodhohen ose shkarkohen mbeturina a mbetje të rrezikshme.

ç) "Mbeturina urbane" kuptohen të gjitha mbetjet jo të rrezikshme që dalin nga ekonomitë shtëpiake dhe veprimtaritë sociale.

d) "Shkarkim" i referohet derdhjes a shpërndarjes së mbeturinave ose mbetjeve të rrezikshme në mjedis.

dh) "Teknologji prodhuese bashkëkohore" kuptohet përdorimi i aparateve, pajisjeve, metodave efikase ose teknologji të tjera që përdoren për të parandaluar ose pakësuar dëmin në mjedis.

3. Mbeturinat e ndryshme që përpunohen me anë të teknologjive prodhuese bashkëkohore nga personat juridikë e fizikë, lejohen të importohen për përfitimin e lëndëve ose materialeve të dobishme, me kusht që nga transporti, depozitimi dhe përpunimi në territorin e vendit këto mbeturina të mos ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe mjedisin rrethues.

Mbeturinat e përmendura në aneksin nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi, lejohen të importohen në vendin tonë. Ndryshimet që mund t'i bëhen aneksit nr.1, propozohen nga Komiteti i Ruajtjes dhe i Mbrojtjes së Mjedisit dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

4. Personi juridik a fizik, nëpërmjet veprimtarisë së tij prodhuese në territorin e Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të bëjë bilancin e lëndëve të para dhe të shkarkimeve në mjedis.

5. Personi juridik a fizik, prodhues, është i detyruar të grumbullojë në një vend të veçantë dhe të përshtatshëm magazinimi brenda territorit të veprimtarisë së tij mbeturinat dhe mbetjet e rrezikshme që rrjedhin prej veprimtarisë, në një mënyrë që të përjashtohet çdo rrezik.

Në vendet e magazinimit brenda territorit të veprimtarisë së tij mund të depozitohen jo më shumë se sasia e formuar gjatë një viti.

6. Shkarkimet që rrjedhin nga veprimtaria prodhuese, nuk duhet të përzihen me mbeturinat urbane.

Për veprimtaritë ekzistuese ekonomike që shkarkojnë mbetje të rrezikshme në rrjetin e ujërave të zeza, afati i ndalimit të këtyre shkarkimeve përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

7. Personi juridik ose fizik prodhues është i detyruar të kujdeset për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme që ai disponon në përputhje me standardet për mbrojtjen e mjedisit.

Personi juridik ose fizik prodhues mund t'i kalojë mbetjet e rrezikshme një personi ose institucioni të autorizuar për trajtimin ose agjësimin e tyre. Në këto raste, përpara transferimit, personi juridik ose fizik prodhues është i detyruar të informojë me shkrim për dërgimin në palën pritëse Komitetin e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Në njoftimin me shkrim të përmendet sasia, përbërja, destinacioni, mënyra e transportit dhe masat e sigurimit të tyre.

8. Mbetjet e rrezikshme, të parashikuara në aneksin nr.2 që i bashkëngjitet këtij vendimi, nuk lejohen të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet në aneksin nr.2 propozohen nga Komiteti i Ruajtjes dhe i Mbrojtjes së Mjedisit dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

9. Në rastin e një rreziku të drejtpërdrejtë dhe me pasoja të ndotjes së mjedisit me mbetje të

rrezikshme, Komiteti i Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit vendos ndalimin e veprimtarisë që shkakton ndotje.

Në qoftë se mjedisi ndotet nga shkarkimet si pasojë e shpërthimit ose i ndonjë fenomeni tjetër me pasoja të njëjta, personi juridik ose fizik prodhues ndalon veprimtarinë prodhuese dhe merr masa të menjëhershme për të mënjeluar rrezikun. Komiteti i Ruajtjes dhe i Mbrojtjes së Mjedisit informohet menjëherë nga ndotësi për avarinë, masat e marra dhe efikasitetin e tyre. Në rast se gjykohet e nevojshme, përcaktohen masa të tjera për të shmangur dëmtimet në mjedis.

Të gjitha shpenzimet në lidhje me mënjanimin e pasojave të ndotjes përballohen nga personi juridik ose fizik, ndotës i tyre.

10. Importimi i mbeturinave nga personat juridikë dhe fizikë bëhet vetëm duke pasur lejen e importit.

Leja e importit të mbeturinave jepet nga Komiteti i Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Ajo është e vlefshme për një afat njëvjeçar. Me kalimin e këtij afati kërkohet leje e re.

Leja e importit përmban detyrimisht deklaratën e importuesit, e cila bëhet nën përgjegjësinë e tij, ku të specifikojë emërtimin e mbeturinës që do të futet në vend, sasinë, përbërjen, destinacionin, llojin e veprimtarisë ku do të përdoren, si dhe respektimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit nga ky përdorim.

11. Personi juridik ose fizik importues i mbeturinave është i detyruar të sigurojë, kundrejt kontratës, ambalazhimit, ngarkimit, transportin dhe shkarkimit për kategoritë e mbeturinave të lejuara për t'u futur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë personi juridik ose fizik importues është i detyruar të ketë nga institucionet e autorizuar nga vendi i prejardhjes deklaratën e konfirmimit të llojit dhe përbërjes të mbeturinës, certifikatat që tregojnë se këto mbeturina nuk paraqesin rreziqe helmuese e mjedisore, si dhe lejen e organeve doganore të vendit nga importohen.

12. Personi juridik ose fizik importues i mbeturinave është i detyruar të ketë në kontratën e transportit gjithë dokumentacionin e nevojshëm legal për transportin ndërkombëtar, si dhe ato që parashikohen në pikën 11. Dokumentet e transportit shoqërojnë ngarkesën gjatë gjithë kohës së transportit deri në destinacionin përkatës.

Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e mjeteve të transportit të ngarkuara me mbeturina lejohet nga organet doganore vetëm pasi paraqitet nga personi juridik ose fizik importues leja e importimit me shkrim nga Komiteti i Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit, si dhe dokumentet e parashikuara në pikën 11.

Mungesa e çdonjërit prej dokumenteve, si dhe moszbatimi i rregullave të transportit, sjell për pasojë moslejimin e hyrjes së mbeturinave në territorin e Republikës së Shqipërisë nga organet doganore.

13. Të drejtën për të pranuar mbeturina të parashikuara në aneksin nr.1 e kanë: pika kufitare tokësore "Qafa e Thanës", "Hani i Hotit", "Kakavije" dhe pika kufitare detare "Porti Durrës".

Kontrolli doganor zhvillohet nën përgjegjësinë e personelit të doganës të specializuar në këtë fushë.

14. Mbetjet e rrezikshme nuk mund të eksportohen nga Republika e Shqipërisë, në qoftë se institucioni i autorizuar i shtetit importues nuk pajis personin juridik ose fizik eksportues me dokumentacionin përkatës të vendit të tij.

Leja për eksportin e mbetjeve të rrezikshme nga personi juridik ose fizik merret në Komitetin e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pasi është depozituar dokumentacioni i lëshuar nga shteti importues.

Kthimi në origjinë i mbetjeve të rrezikshme të eksportuara detyron personin juridik ose fizik eksportues të përgjigjet për asgjësimin e tyre me shpenzimet e tij, si dhe është përgjegjës për shpenzimet e tjera që mund të dalin si pasojë e transportit të papërshtatshëm.

15. Nëse gjatë kontrollit në veprimtaritë prodhuese, importit, eksportit dhe transportit brenda vendit vërehen shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, shpenzimet e shkaktuara nga veprimet e kontrollit dhe masat e nevojshme për normalizimin e gjendjes përballohen nga personi juridik ose fizik ndotës.

16. Inspektorët e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe punonjësit e Policisë Financiare, për kryerjen e detyrave sipas këtij vendimi, bashkëpunojnë me organet doganore sipas udhëzimit që miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit dhe ministri i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

A N E K S I I

LISTA E MBETJEVE QË LEJOHEN TË IMPORTOHEN NË VENDIN TONË

1. Mbeturina çeliku
2. Mbeturina të fonderisë
3. Mbeturina të bakrit
4. Mbeturina të tunxhit
5. Mbeturina të bronxhit
6. Mbeturina të copave të qelqit
7. Mbeturina të letrës dhe kartonit
8. Mbeturina të filaturës së pambukut dhe të leshit
9. Mbeturina të fabrikave të trikotazhit të pambukta dhe të leshta

A N E K S I I I

LISTA E MBETJEVE TË RREZIKSHME QË NUK LEJOHEN TË FUTEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

1. Mbetjet klinike nga shërbimi mjekësor në spitale, qendra dhe klinika mjekësore.
2. Mbetje prej prodhimit dhe formulimit të produkteve farmaceutike.
3. Prodhime farmaceutike me afat të tejkaluar (të skaduara).
4. Mbetje farmaceutike barnash e medikamentesh.
5. Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të biocideve dhe të lëndëve fitofarmaceutike.
6. Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të kimikateve që shërbejnë për ruajtjen e drurit.
7. Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të solventeve organike.
8. Mbetje prej trajtimit me nxehtësi dhe operacioneve të temperimit me përmbajtje cianuresh.
9. Mbetje vajrash minerale të papërshtatshme për përdorimin origjinal të përcaktuar.
10. Mbetje të përzjerjeve e të emulsioneve të vajërave me ujë dhe të hidrokarbureve me ujë.
11. Mbetje lëndësh dhe artikujsh që përmbajnë ose janë të ndotura me bifenile të poliklorinuara (PCB), me terfenile të poliklorinuara (PCT) ose me bifenile të polibromuara (PBB).
12. Mbetje të katranit të rrjedhura prej përpunimit, distilimit dhe çdo trajtimi me pirolizë.
13. Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të bojërave (shkrimi) ngjyruese, pigmenteve të bojërave (për të lyer), vernikeve, llakeve.
14. Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të rrëshirës, lateksit, plastifikatorëve, lëndëve ngjitëse, tutkallit.
15. Mbetje lëndësh kimike që rrjedhin prej punës mësimore kërkimore dhe zhvillimit të aktiviteteve të cilat nuk janë identifikuar ose janë të reja dhe efektet e të cilave mbi njeriun dhe mjedisin nuk njihen.
16. Mbetjet me natyrë eksplozive që nuk janë objekt i ndonjë legjislacioni tjetër.
17. Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të kimikateve fotografike dhe materialeve të përpunuara.
18. Mbetje që rrjedhin nga trajtimi sipërfaqësor i metaleve dhe lëndëve plastike.
19. Mbetje prej operacioneve të asgjësimit të mbetjeve industriale.

MBETJE QË KANË NË PËRBËRJE:

20. Karbonile të metaleve.
21. Beril, komponime të berilit.
22. Komponime të kromit gjashtëvalent.
23. Komponime të bakrit.
24. Komponime të zinkut.
25. Arsenik dhe komponime të arsenikut.
26. Selen dhe komponime të selenit.
27. Kadmium dhe komponime të kadmiumit.
28. Antimon dhe komponime të antimonit.
29. Telur dhe komponime të telurit.
30. Mërkur dhe komponime të mërkurit.
31. Plumb dhe komponime të plumbit.
32. Komponime inorganike të fluorit, duke përjashtuar flururin e kalciumit.
33. Cianure inorganike.
34. Solucione acide ose acide në trajtë të ngurtë.
35. Solucione bazike ose baza në trajtë të ngurtë.
36. Asbest (pluhur dhe fibra).
37. Komponime organike të fosforit.
38. Cianure organike.
39. Fenole, komponime të fenolit duke përfshirë klorofenole.
40. Etere.
41. Tretës organik të halogjenizuar.
42. Tretës organikë përveç solventeve të halogjenuar.
43. Çdo derivat i dibenzo-furanit të polikloruar.
44. Çdo derivat i dibenzo-p-dioksinës së polikloruar.
45. Komponime organike të halogjenuara, të tjera veç lëndëve të përmendura në këtë aneks (p.sh. 39, 41, 42, 43, 44).
46. Mbetjet që rrjedhin prej djegies të mbeturinave urbane.